3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja

e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
 - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 te LPP dhe nenin 75 te VKM 285/2021.
 3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]
[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

QSUNT, ka në inventarin e saj 38 ashensorë, 2 pedana ngritese hidraulike dhe 5 dyer mekanike (kundra rrezatimit), sipas pasqyrës që jep të dhëna teknike dhe gjëndjen e tyre teknike.

Shërbimet dhe riparimet, që do të kryhen janë për 36 ashensorë, 2 pedana hidraulike si dhe për 5 dyer mekanike, të përshkruara në preventivin bashkëlidhur, por në kushte spitalore, ç'ka presupozon që do të kryhen në kohë të përshtatshme, pa penguar lëvizjen e të sëmurëve, dhe me cilësi, gjatë 24 orëve/24 për 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Mirëmbajtja dhe riparimet e ashensorëve, do të kryhen sipas preventivit pjesë përbërëse e kontratës, për zbatimin e së cilës lëshohen "Urdhëra Pune" nga specialistët përkatës të Sektorit Teknik të QSUNT, dhe në përfundim të shërbimeve teknike apo riparimeve hartohet proces verbali i marrjes në dorëzim, ku nënshkruajnë të dy/tre palët.

"Urdhëri i Punës" për riparime të defekteve të çastit, shoqërohet me preventiv të hartuar nga përfaqësuesi i QSUNT-së, dhe nënshkruhet edhe nga Sipërmarrësi, i cili merr përsipër zbatimin në afat e me cilësi të detyrave të dhëna në "Urdhërin e Punës", me cilësi dhe në kohë.

A. Specifikime teknike"

- Preventivi përmban zonën e kryerjes së shërbimeve teknike, llojin dhe specifikimin teknik të shërbimit të riparim-mirëmbajtës, njësinë, sasinë, çmimin, vlerën dhe kohën e kryerjes së riparimit të defekteve. Pjesë e preventivit është pasqyra me të dhëna teknike të ashensorëve sipas godinave ku janë të instaluar.
- Preventivi me të dhënat e mësipërme është pjesë përbërëse e kontratës.
- Të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje, duhet të jenë të certifikuara (CE) ose (FDA).

B. Kërkesat të veçanta teknike:

- Ofertuesit të njihen me ashensorët dhe të deklarojnë që marrin përsipër kryerjen e këtyre riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë dhe me cilësinë e kërkuar për shërbim spitalor.
- Ofertuesit të kenë persona përgjegjës për kryerjen e riparimit të çdo defekti të mundshëm, duke deklaruar ato me lidhjen e kontratës.
- Sipërmarrësi duhet të kontaktojë çdo ditë me përfaqësuesin e QSUNT-së, për ndjekjen e zbatimit të kontratës.

C. Vendi i kryerjes së riparim-shërbimeve është:

- Në të gjitha Godinat Spitalore të QSUNT-së (ku janë në funksionim ashensorët): Onkologjik, Infektiv, Djegie-Plastikë, Kirurgji e Përgjithshme, Spitali i Ri, Sëmundjet e Brendëshme, Kardiokirurgji, Spitali Francez, Pediatri, Neurokirurgji dhe Neurologji, Akselatori Onkologjik, Akselatori i Neurokirurgjisë, Qendra e Konsultave si dhe Depo Qendrore e Farmacisë .

D. Grafiku i lëvrimit (koha e kryerjes së riparim-shërbimeve):

- Shërbimet teknike dhe riparimet e planifikuara jepen me "Urdhër Pune", dhe do të kryhen nga ora 8:30 deri në 20:00, në ditë të shtuna dhe diela, në ditët e pushimit dhe festave zyrtare, pa e penguar kryerjen e shërbimit spitalor.
- Për rastet e defekteve të çastit (emergjente), riparim-shërbimet do të kryhen me marrjen e njoftimit, menjëherë, çdo ditë dhe në çdo orë.

INVENTARI ME SPECIFIKIME TEKNIKE DHE KËRKESA PËR PËRDORIM TË ASHENSORËVE

Nr.	Vendinstalimi i ashensorit - Objekt i mirëmbajtjes-	Viti i vënies në punë	Nr. i Kateve	Funksioni (përdorimi)	Permasat e kabinave (në mm)	Kërkohe të arrihet që të gjitha ditët kalendarike ashensorët të jenë të gatshëm për përdorim (Orë pune /ditë)
1	Spitali Nr.1	2011	7	Per barrela/përsone	2440x1460	16
2	Spitali Nr.1	2011	6	Deri 6 përsone	1300x960	16
3	Neurokirurgjia	2018	4	Per barrela/përsone	2470x1380	10
4	Neurokirurgjia	2011	4	Per barrela/përsone	2470x1380	8
5	Neurokirurgjia	2011	2	Për materiale sallës	750x420	3
6	Neurokirurgjia	2012	2	Për materiale sallës	750x420	4
7	Neurologjia	2011	5	Per barrela/përsone	2470x1380	14
8	Neurologjia	2014	5	Deri 6 përsone	1300x960	14
9	Neurologjia	2014	2	Kuzhinë/materiale	750x420	4
10	Pediatria	2011	4	Per barrela/përsone	1400x2400	16
11	Pediatria	2011	4	Per barrela/përsone	1400x2400	14
12	Ish/Kirurgjia e Përgjithshme	2011	2	Per barrela/përsone	2441x1400	8
13	Kardiokirurgjia	1996	4	Per barrela/përsone	2470x1380	16
14	Djegje-Plastika	2004	4	Per barrela/përsone	2400x1400	12
15	Infektiv	2004	5	Per barrela/përsone	2400x1400	18
16	Onkologjiku	2004	4	Per barrela/përsone	2440x1460	12
17	Onkologjiku	2004	2	Per kuzhine	1300x960	4
18	Onkologjiku	2004	2	Per sallën	1300x960	4
19	Spitali Francez	2005	2	Per barrela/përsone	2400x1400	10
20	Spitali Francez	2005	2	Per barrela/përsone	2400x1400	6
21	Qendra e Konsultave	2015	2	Deri 6 përsone	1500x1500	8
22	Spitali i Ri	2011	4	Deri 12 përsone	1500x1400	18
23	Spitali i Ri	2011	4	Deri 12 përsone	1500x1400	18
24	Spitali i Ri	2011	4	Per barrela/përsone	1450x2600	12
25	Spitali i Ri	2011	4	Per barrela/përsone	1450x2600	12
26	Spitali i Ri	2011	2	Deri 9 përsone	950x1800	0
27	Spitali i Ri	2011	2	Deri 9 përsone	950x1800	0
28	Spitali i Ri	2011	4	Deri 12 përsone	1300x1580	12
29	Spitali i Ri	2011	4	Deri 12 përsone	1300x1580	12
30	Spitali i Ri	2011	4	Per barrela/përsone	1500x2500	18
31	Spitali i Ri	2011	4	Per barrela/përsone	1500x2500	18
32	Spitali i Ri	2011	4	Deri 13 përsone	1300x1530	14
33	Spitali i Ri	2011	4	Deri 13 përsone	1300x1530	14
34	Spitali i Ri	2011	4	Deri 13 përsone	1450x1600	14
35	Spitali i Ri	2011	4	Deri 13 përsone	1450x1600	14
36	Depo Farmaceutike	Shk-2020	3	Industrial / Cargo	2400x2000	4
37	Depo Farmaceutike	Shk-2020	3	Industrial / Cargo	2400x1800	2
38	Depo Farmaceutike	Shk-2020	3	Deri 4 persona	1250x1000	4

39	Depo Farmaceutike	Shk-2020	50cm	Pedanë hidraulike	2500x2100	4
40	Depo Farmaceutike	Shk-2020	50cm	Pedanë hidraulike	2000x1800	2

Nr.	Vendi i Deres Objekt i Mirëmbajtjes	Viti i Vënies në Punë	Nr. i Hapjeve	Funksioni (Përdorimi)	Kërkohe të arrihet që të gjitha ditët kalendarike ashensore të jenë të gatshëm për përdorim (Orë pune /ditë)
1	Bunkeri i Akseleratorit Neurokirurgji	2015	1	Dere mbrojtese nga rrezatimi	8
2	Bunkeri i Akseleratorit Onkologjik	2016	1	Dere mbrojtese nga rrezatimi	8
3	Bunkeri i Akseleratorit Onkologjik	2016	2	Dere xhami per akses	8
4	Spitali 6 KT hyrja kryesore kati - 1	2013	2	Dere xhami per akses	24
5	Spitali 6 KT hyrja kryesore kati 1	2013	2	Dere xhami per akses	24

➤ ***Mirembajtja dhe shërbimet objekt I kesaj procedure prokurimi do te kryhen ne baze te VKM Nr.192 date 04.04.2018 “Per miratimin e Rregullit Teknik “Per ashensore dhe komponentet e sigurise per ashensore dhe percaktimin e listes se standarteve te harmonizuara”.***

Shtojca 6

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohen:

Nr.	Emërtimi - Zona e Kryerjes së Riparim-Shërbimeve	Njësia / Përshkrimi I Riparim- Shërbimeve Mirëmbajtëse	Njësia	Sasia per 24 MUAJ
1	Kabina e Ashensorit	Gjëndja e dyshemesë . Mbyllja mekanike + elektrike e dyerve. Ndriçimi i kabinës. Butonat dhe llampat e prenotimit. Butonat hapje dhe mbyllje porte. Ventilatori+gjëndja në tërësi	Orë Pune	3330
2	Tavani i Kabinës	Gjëndja e tavanit të kabinës Kontroll, pastrim, rregjistikim operatori Kontakti i parashutës. Vajisje e shinave të kabina+k/peshave. Gominat e fiksimit kabinë-arkade. Kontroll tokëzimi kavo, kabinë arkade. Gjëndjen e fijeve flesibël	Orë Pune	2390
3	Salla e Makinerive	Pastrimi dhe ndriçimi i sallës . Provë rregullatorit, valvolës së rënies Kontroll gjëndjes kavos së rregullatorit Kontroll funksionimit të automatëve Provë dispozitivit . Gjëndja në tërësi emergjencës	Orë Pune	3530
4	Arganello e Ashensorit	Kontroll i nivelin e vajit në reduktor Kontroll i ventilatorit ftohës. Pastrimi i elektromotor, reduktor . Kontroll për xhoko vidë-koronë, pastrimi i temburos së kontroll pulexhos el/motorit+devijimet, fortësisë së sustës së frenitfrenit. Kontroll gjëndjen e ferrotave të frenit	Orë Pune	3530
5	Kafazi i Ashensorit	Pastrimi, shtrëngimi i stafave të shinave. Pastrimi, shtrëngimi i dyerve të katit. Kontroll i stafave të petashuqeve. Ndriçimi i kafazit. Tokëzimi i shinave	Orë Pune	3880
6	Kuadri i Manovrës	Kontroll zhurme lëshues, rele etj. Shtrëngim fije tek lëshuesit dhe relet . Provë + rregjistikim termikun e thithjes Kontroll tokëzimit të kuadrit. Kontroll përfaqimi i morsetave tek skeda. Pastrim skede, kontroll transformatori	Orë Pune	3990
7	Arkaden	Kontroll dado tirante, morsetat e kavove .Kontroll morsetat e kavos së rregullatorit. Shtrëngimi i bulonave të arkaden Kontroll xhoko (hapsire) guarnicioneve Gjëndja e tirantit, prova e parashutës. Kontroll arkades, k/peshës dhe kovot Vajisje shinave, kabinë+kundrapesha Gjëndja fizike në tërësi	Orë Pune	2396
8	Gropa e Ashensorit	Kontroll, pastrim i gropës. Kontroll i deviatorit dhe prizës. Kontroll i gjëndjes së sustës+zinxhirit. Kontroll distc. kabinë-k/peshë-susta. Kontroll kontakti kavos së rregullatorit. Kontroll gjëndjes pulexhos tendikavos. Kontroll i zgjatjes së kavos rregullatorit. Kontroll bazamentit, korodimit shinave	Orë Pune	2280
9	Portat e Kateve	Kontroll i mbylljes mekanike dyerve Kontakti elektrik, çelësi i emergjencës, pastrim i kasës sipër dhe i karelit Kontroll-rregjistikim i hapsirës ulave. Kontroll për konsumim, shtrëngim i patinave rulat e akopjimit. Provë Kontroll i zhurmës së derës në hapje butonave + llampat e kateve	Orë Pune	3568
10	Të përgjithshme	Gjithnjë bëhet kontroll i funksionimit të impiantit, alarmit, llampës së emergjencës dhe manovrën me dorë	Orë Pune	1750
11	Në çdo tre muaj bëhet këto verifikime dhe kontrolle	Funksionimin e alarmit pa tension, Konsumin, zgjatjen, rrëshqitjen e kavove. Tokëzimin e ashensorit. Limitatorin e shpejtësisë. Kontroll i qarqeve të sigurisë dhe mbrojtjes. Distanca kat-kabinë (max 30 mm). Valvolën e rënies, Efikasitetin e termikut	Orë Pune	2560
12	F.V. Vajnica Dhe Vaj Makine		Copë	34
13	F.V. Graso Në Nyjet Lëvizëse		Kg	18
14	F.V. Vaj Hidraulik 46		Litra	280

15	F.V. Llampa 100 W Per Ndrëqimin E Pusit	Copë	18
16	F.V. Çelsa Te Dyerve Te Kateve	Copë	34
17	F.V. Çelsa Avarie Te Kabines	Copë	34
18	F.V. Butona Te Thirrjes Se Kateve	Copë	34
19	F.V. Mekanizëm Dere Mekanike	Copë	4
20	F.V. Rripa Transmisioni Të Dyerve	Copë	138
21	F.V. Llampa Kabine Per Ndrëqim	Copë	24
22	F.V. Sensorë Manjetik	Copë	18
23	F.V. Guarnicion Pistoni	Copë	8
24	F.V. Automat Termo/El.Manj. Diferencial 2P, 220 V, 63A	Copë	10
25	F.V. Automat Magneto-Termik 380 V, 25A, 4P, Id=0,03A	Copë	18
26	F.V. Rrëshkitëse Kabine 7mm	Copë	8
27	Butona Tregues Te Dyerve Te Jashtme	Copë	24
28	Butoneri E Brendeshme	Copë	24
29	F.V Kabëll Fleksibël Ashensori	MI	60
30	F.V Kavo Çeliku Fi 12 Ashensoret	MI	1200
31	F.V. Patina Portash	Copë	116
32	F.V. Rula Për Hapje Dhe Mbyllje Dere	Copë	116
33	F.V. Ferrota Për Frenat E Motorrit	Copë	60
34	F.V. Inverter Dyersh	Copë	14
35	F.V. Pult Komandimi	Copë	14
36	F.V. Lëshues 63A	Copë	18
37	F.V. Operator Kabine	Copë	10
38	F.V. Kuadër Manovre (Panel Komandimi)	Copë	10
39	F.V Panel Ashensori VVVF (Paneli Elektrik 15 Kw)	Copë	10
40	F.V Motor Mekanik Kabine (24V DC)	Copë	12
41	F.V.Fotocelule (12 V DC)	Copë	24
42	F.V.Akses Karte	Copë	12
43	F.V Kontaktet E Dyerve Te Jashteme	Copë	60
44	F.V Display	Copë	34

Afatet e ekzekutimit: 24 muaj nga data e nënshkrimit te mareveshjes kuader.

Afatet e lëvrimit:

Për çdo kontrate të lidhur brenda marrëveshjes kuadër, sipas përcaktimit më sipër, afatet e lëvrimit do të jene si me poshtë:

- 15% e sasisë për secilin material mjekësor do të lëvrohet brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit te kontratës.
- pjesa e sasisë se mbetur duhet të lëvrohet deri ne përfundim te kontratës dhe sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktor.

Shtojca 7

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Riparim Mirëmbajtje e Ashensorëve te QSUT”

Detyrat: Sipas kërkesave të autoriteteve kontraktore dhe në përputhje me specifikimet teknike.

Shpërndarja:

Nr.	Vendinstalimi i ashensorit - Objekt i mirëmbajtjes-	Viti i vënies në punë	Nr. i Kateve	Funksioni (përdorimi)	Permasat e kabinave (në mm)	Kërkohe të arrihet që të gjitha ditët kalendarike ashensoret të jenë të gatshëm për përdorim (Orë pune /ditë)
1	Spitali Nr.1	2011	7	Per barrela/përsonel	2440x1460	16
2	Spitali Nr.1	2011	6	Deri 6 përsona	1300x960	16
3	Neurokirurgjia	2018	4	Per barrela/përsonel	2470x1380	10
4	Neurokirurgjia	2011	4	Per barrela/përsonel	2470x1380	8
5	Neurokirurgjia	2011	2	Për materiale sallës	750x420	3
6	Neurokirurgjia	2012	2	Për materiale sallës	750x420	4
7	Neurologjia	2011	5	Per barrela/përsonel	2470x1380	14
8	Neurologjia	2014	5	Deri 6 përsona	1300x960	14
9	Neurologjia	2014	2	Kuzhinë/materiale	750x420	4
10	Pediatria	2011	4	Per barrela/përsonel	1400x2400	16
11	Pediatria	2011	4	Per barrela/përsonel	1400x2400	14
12	Ish/Kirurgjia e Përgjithshme	2011	2	Per barrela/përsonel	2441x1400	8
13	Kardiokirurgjia	1996	4	Per barrela/përsonel	2470x1380	16
14	Djegje-Plastika	2004	4	Per barrela/përsonel	2400x1400	12
15	Infektivi	2004	5	Per barrela/përsonel	2400x1400	18
16	Onkologjiku	2004	4	Per barrela/përsonel	2440x1460	12
17	Onkologjiku	2004	2	Per kuzhine	1300x960	4
18	Onkologjiku	2004	2	Per sallën	1300x960	4
19	Spitali Francez	2005	2	Per barrela/përsonel	2400x1400	10
20	Spitali Francez	2005	2	Per barrela/përsonel	2400x1400	6
21	Qendra e Konsultave	2015	2	Deri 6 përsona	1500x1500	8
22	Spitali i Ri	2011	4	Deri 12 përsona	1500x1400	18
23	Spitali i Ri	2011	4	Deri 12 përsona	1500x1400	18
24	Spitali i Ri	2011	4	Per barrela/përsonel	1450x2600	12
25	Spitali i Ri	2011	4	Per barrela/përsonel	1450x2600	12
26	Spitali i Ri	2011	2	Deri 9 përsona	950x1800	0
27	Spitali i Ri	2011	2	Deri 9 përsona	950x1800	0
28	Spitali i Ri	2011	4	Deri 12 përsona	1300x1580	12

29	Spitali i Ri	2011	4	Deri 12 përsone	1300x1580	12
30	Spitali i Ri	2011	4	Per barrele/përsone	1500x2500	18
31	Spitali i Ri	2011	4	Per barrele/përsone	1500x2500	18
32	Spitali i Ri	2011	4	Deri 13 përsone	1300x1530	14
33	Spitali i Ri	2011	4	Deri 13 përsone	1300x1530	14
34	Spitali i Ri	2011	4	Deri 13 përsone	1450x1600	14
35	Spitali i Ri	2011	4	Deri 13 përsone	1450x1600	14
36	Depo Farmaceutike	Shk-2020	3	Industrial / Cargo	2400x2000	4
37	Depo Farmaceutike	Shk-2020	3	Industrial / Cargo	2400x1800	2
38	Depo Farmaceutike	Shk-2020	3	Deri 4 persona	1250x1000	4
39	Depo Farmaceutike	Shk-2020	50cm	Pedanë hidraulike	2500x2100	4
40	Depo Farmaceutike	Shk-2020	50cm	Pedanë hidraulike	2000x1800	2

Nr.	Vendi i Deres Objekt i Mirëmbajtjes	Viti i Vënies në Punë	Nr. i Hapjeve	Funksioni (Përdorimi)	Kërkohe të arrihet që të gjitha ditët kalendarike ashensore të jenë të gatshëm për përdorim (Orë pune /ditë)
1	Bunkeri i Akselatorit Neurokirurgji	2015	1	Dere mbrojtese nga rrezatimi	8
2	Bunkeri i Akselatorit Onkologjik	2016	1	Dere mbrojtese nga rrezatimi	8
3	Bunkeri i Akselatorit Onkologjik	2016	2	Dere xhami per akses	8
4	Spitali 6 KT hyrja kryesore kati - 1	2013	2	Dere xhami per akses	24
5	Spitali 6 KT hyrja kryesore kati 1	2013	2	Dere xhami per akses	24

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza" Tirane.

Shtojca 8

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :
Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas **Shtojcës 1**;
- b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas **Shtojcës 2**;
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9**;
- d. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 3**;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi **“Sistemet e menaxhimit të cilësisë”**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2018, 2019, 2020**) ku vlera e xhiros **per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar** duhet të jete jo me e vogel se **100 % e vleres se fondit limit*** të kontratës që prokurohet.

Shënim:* Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 100 % do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar në **Seksionin: 2.10 Përshkrim i shkurtër i kontratës/Marrëveshjes Kuadër, pika 1.**

2.3 Kapaciteti teknik:

- a) Dëshmi nga operatori ekonomik për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbime të mëparshme, të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë **jo më të vogël 40% e vlerës** së përlogaritjes të kontratës që prokurohet dhe **që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, **kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës**, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të **deklaruar në organet tatimore****, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim:* Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 40% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme për të cilën ofertohej, **konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në piken 2.10.**

- b) Autodeklarate nga ofertuesi që të gjitha materialet që do të përdoren për riparime dhe furnizim vendosje, duhet të jenë të çertifikuara (CE) ose (FDA).

c) Liçensë profesionale e Shoqërisë e vlefshme me kategorinë: **NS-3 A Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).**

d) Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Tetor 2020 - Shtator 2021 ku të ketë një punësim mesatar prej 10 punonjësish, ku të përfshihet dhe stafi i shoqërisë, të shoqëruara me listëpagesat (formularët E-sig 025) të konfirmuara nga Drejtoria e tatimeve, shoqëruar gjithashtu dhe me **formularët e deklaratimit të pagesës të sigurimeve shoqërore dhe TAP për periudhat e mësipërme.**

e) Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar punonjësit me kualifikime teknike për fushën përkatëse në përputhje me objektin e prokurimit, në specialitetet si më poshtë:

- **2 Punonjës Elektricitëse** (të pajisur me dëshmi kualifikimi nga Inspektoriati Shtetëror Përgjegjës për Sigurinë e Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike ose nga një organ i akredituar certifikues personeli)

- **1 Punonjës Mekanik** (i pajisur me dëshmi kualifikimi nga Inspektoriati Shtetëror Përgjegjës për Sigurinë e Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike ose nga një organ i akredituar certifikues personeli)

- **2 Punonjës Teknikë** (të pajisur me dëshmi kualifikimi nga Inspektoriati Shtetëror Përgjegjës për Sigurinë e Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike ose nga një organ i akredituar certifikues personeli)

Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë CV e Drejtuesve Teknikë, kontratë pune si dhe libereze pune, të figurojnë në licencën e shoqërisë pasi mosqenia në licencën e shoqërisë e drejtuesit teknik është kusht skualifikues, si dhe një deklaratë e cila përcakton se Drejtuesi Teknik është i punësuar pranë kësaj shoqërie me kohë të plotë pune dhe do jetë në dispozicion të realizimit të objektit.

g) Operatori ekonomik duhet të ketë staf të kualifikuar për drejtimin e punimeve/sherbimeve objekt prokurimi në përberjen e të cilit duhet të jetë minimalisht:

- **1 Inxhinier Mekanik** (paraqitje e kontratës individuale të punës, diplomës, si dhe të Figurojë në listë pagesat e shoqërisë sipas periudhave të lartcituara në këtë shtojcë të DST) **Inxhinieri mekanik duhet të figurojë në Licencën e Shoqërisë, pasi mosqenia në licencën e shoqërisë e këtij kapaciteti është kusht skualifikues.**

Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

h) Operatori ekonomik duhet të ketë staf të kualifikuar për drejtimin e punimeve/sherbimeve objekt prokurimi në përberjen e të cilit duhet të jetë minimalisht:

- **1 Inxhinier Elektrik** (kerkohet paraqitje e kontratës individuale të punës, diplomës, si dhe të figurojë në listë pagesat e shoqërisë sipas periudhave të lartcituara në këtë shtojcë të DST).

Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

i) Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose qira mjetet e pajisjet teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë :

Lloji i makinerise (pajisjes)	Njesia	Sasia
Gjenerator	cope	1
Shkalle te levizshme	cope	2
Trapan	cope	2
Gur fresibel	cope	2
Saldatrice	cope	1

- Makinerite - pajisjet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuara (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi).
- Makinerite - pajisjet me qira të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar).
- Për mjetet që shihen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, taksat vjetore, leje transporti minimalisht për 1 automjet (kamioncine) dhe çertifikatën e pronësisë së mjetit). Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat e blerjes – kopje e noterizuar.

Shenim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Shërbimet /Mallrat e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
